



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 617 Prot

Datë 16/03/2022



ILD
INSTITUTI I LARTË I DREJTËSISË

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË



INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE



INSTITUTI PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



INSTITUTI PËR STUDIME PUBLIKE E LIGJORE



INSTITUTI SHQIPTAR I SHKENCAVE



QENDRA EUROPIANE

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

DHE

ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Preambula,

Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe organizatat e shoqërisë civile, Instituti për Studime Publike e Ligjore (ISPL), përfaqësuar nga Z. Ardian Dhima; Instituti i Studimeve Politike (ISP), përfaqësuar nga Z. Afrim Krasniqi; Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (IBZH), përfaqësuar nga Znj. Krisela Hackaj, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), përfaqësuar nga Znj. Erida Skëndaj, Qendra Europiane (QE), përfaqësuar nga znj. Ina Xhepa, Instituti Shqiptar i Shkencave (AIS), përfaqësuar nga znj. Aranita Brahaj;

referuar në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi si “Palë”;

Duke vlerësuar se organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm në forcimin e proceseve demokratike, konsolidimin e qeverisjes së mirë, respektimin e të drejtave të njeriut, sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe për formësimin e kontributit të tyre nëpërmjet krijimit të mekanizmave institucionalë të bashkëpunimit me institucionet publike;

Duke vlerësuar rëndësinë e përmirësimit të sistemit të drejtësisë në kuadër të forcimit të shtetit të së drejtës, politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra për funksionimin e një sistemi drejtësie profesional, të përgjegjshëm, llogaridhënës dhe transparent;

Duke pasur parasysh fushat e përbashkëta të interesit, me synim rritjen e transparencës në raport me veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe përmirësimin e aksesit të publikut në informacion;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, për të përmbushur edhe angazhimet, të cilat rrjedhin nga detyrimet ligjore;

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor, që rregullon veprimtarinë institucionale të palëve, si ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar dhe ligji nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”;

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim referuar si “Marrëveshja”.

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i bashkëpunimit është vendosja e komunikimit në vijimësi, mes shoqërisë civile dhe Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes proceseve transparente të monitorimit të veprimtarisë dhe rritjes së besimit të publikut, në drejtim të ndërgjegjësimit të opinionit publik mbi misionin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Kjo marrëveshje bashkëpunimi nuk përbën një dokument ligjor, ndaj nëse palë të caktuara do të angazhohen të realizojnë projekte të përbashkëta, do të jetë objekt i marrëveshjeve të veçanta mes palëve në fjalë që do të rregullojë të drejtat dhe detyrimet e palëve në kuadër të projekteve ndërmjet tyre.

Neni 2

Objekti i bashkëpunimit

1. Palët me synim rritjen e performancës dhe ngritjen e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet kësaj marrëveshje angazhohen në rritjen e komunikimit dhe zhvillimin e një sërë aktivitetesh të përbashkëta, në kuadër të monitorimit, analizimit, procesit llogaridhënës dhe ndërgjegjësues mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes shkëmbimit të të dhënave, organizimit të takimeve periodike, ofrimit të ekspertizës përkatëse të OSHC-ve të specializuara, apo *think-tank*.

2. Secila nga palët në këtë marrëveshje angazhohet të veprojë bazuar me frymën e bashkëpunimit, promovimit të qëllimeve dhe interesave të përbashkëta, mbrojtjes së integritetit dhe profesionalizimit, në respektim të konfidencialitetit, të dhënave personale dhe pronësinë intelektuale të informacioneve, produkteve dhe materialeve që shkëmbehen në kuadër të këtij bashkëpunimi.

Neni 3

Forma e bashkëpunimit

Palët në marrëveshje kanë rënë dakord që forma e bashkëpunimit mes tyre të arrihet përmes:

a) Informimit të vazhdueshëm me synim pjesëmarrjen dhe përfshirjen e OSHC-ve në sigurimin e informacionit.

b) Konsultimit me OSHC-të duke kërkuar mendimin, pikëpamje dhe opinione për një temë të caktuar politikash apo procese zhvillimi, si dhe me kërkesë të OSHC-ve, në formën e dëgjësive publike, tryezave të punës ose konferencave në të cilat ftohet dhe merr pjesë Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

c) Dialogut për interesa të ndërsjella dhe objektiva të përbashkëta për të siguruar një shkëmbim të rregullt pikëpamjesh mes takimeve apo marrëveshjeve të mëtejshme bashkëpunimi specifik.

ç) Partneritetit me përgjegjësi të përbashkëta në përcaktimin e programeve dhe zbatimin e aktiviteteve.

Neni 4

Llojet e aktiviteteve të mundshme

Palët në bashkëpunim kanë rënë dakord për organizimin e aktiviteteve me interes të ndërsjellë dhe qëllimi i bashkëpunimit do të realizohet duke u angazhuar, por duke mos u kufizuar në aktivitet e mëposhtme:

a) Vënies në dispozicion të të dhënave të kërkuara, sipas aktiviteteve të planifikuara në planin e veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, dhe informacionit në funksion të monitorimit të kërkuar nga palët;

b) Dhënies së informacioneve rreth veprimtarisë, për qëllime të publikimit periodik në faqen e ILD-së;

c) Organizimit të takimeve periodike pranë ILD-së;

ç) Monitorimit të veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në kuadër të masave dhe aktiviteteve të përcaktuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Sistemit të Drejtësisë dhe të Planit të Veprimit për periudhën 2022– 2025, në periudha 4 mujore;

d) Organizimit të takimeve të përbashkëta, në funksion të procesit të monitorimit;

dh) Përgatitjes së raporteve analitike të monitorimit, duke përcjellë mendim mbi zgjidhjet alternative;

e) Organizimit të aktiviteteve ndërgjegjësuere për publikun;

ë) Konceptimin e materialeve të thjeshtuara, me informacion mbi veprimtarinë periodike të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

f) Organizimin e trajnimeve, ndarjes së praktikave më të mira, të workshop-eve, me tematika të dakordësuara nga palët;

g) Ofrimit të trajnimeve në lidhje me raportimet në kuadër të procesit të integritetit evropian, dhe /ose komunikimin me publikun, në funksion të rritjes së ndërgjegjësimit mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

h) Përfshirjen, referimin, promovimin e këtij modeli bashkëpunimi dhe të rezultateve respektive në aktivitetet e palëve të kësaj marrëveshjeje me palë të treta, dhe në komponentët e komunikimit dhe të advokimit në Shqipëri, Rajon dhe BE.

Neni 5

Gjuha

Palët paraqesin informacionin e rënë dakord në gjuhën shqipe.

Neni 6

Vlerësimi i zbatimit të marrëveshjes

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht funksionimin e bashkëpunimit në mbështetje të marrëveshjes, nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së raportit mbi ecurinë e bashkëpunimit.

2. Raporti përmban, krahas të dhënave për mënyrën e zbatimit të marrëveshjes, edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara.

3. Ky raport përgatitet një herë në vit dhe nënshkruhet nga të gjitha palët. Një version publik me të dhëna që respektojnë detyrimet për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë publikohet në *website*-et e të gjithë palëve.

Neni 7

Komunikimi mes Palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e qëllimit të bashkëpunimit. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore dhe/ ose në rrugë elektronike.

2. Palët caktojnë personat e kontaktit, që do të jenë përgjegjës për shkëmbimin e informacionit dhe plotësimin e kërkesave të tyre, në zbatim të marrëveshjes.

3. Palët informojmë njëra-tjetrën mbi personat e kontaktit, jo më vonë se 15 ditë nga nënshkrimi i kësaj marrëveshje.

4. Në rast të ndryshimit të personave të kontaktit, palët do të njoftojnë ndryshimet përkatëse.

Neni 8

Kostot financiare

Kostot financiare, që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshje, i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore, që Palët kanë në dispozicion.

Neni 9

Ndryshimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve, nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 10

Përfundimi i marrëveshjes

1. Marrëveshja lidhet pa afat, por mund të përfundojë në çdo kohë, me marrëveshje mes Palëve. Përfundimi hyn në fuqi një muaj pas marrjes së njoftimit me shkrim nga njëra prej Palëve.

2. Deri në përfundimin e kësaj Marrëveshje, Palët iu përmbahen kushteve, që rrjedhin nga kjo marrëveshje, për sa i përket informacionit dhe dokumenteve të shkëmbyera përpara datës së përfundimit.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 12

Hyrja në Fuqi

1. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.

2. Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 7 (shtatë) kopje origjinale. 1 (një) kopje depozitohet pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 6 (gjashtë) kopje u depozitohen palëve pjesëmarrëse në këtë marrëveshje.

Kjo marrëveshje nënshkruhet sot në Tiranë, më datë 16 mars 2022.

**PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË**

**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË
ARTUR METANI**



PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

**INSTITUTI PËR STUDIME PUBLIKE E
LIGJORE (ISPL)
Z. ARDIAN DHIMA**

**INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE (ISP)
Z. AFRIM KRASNIQI**

**INSTITUTI PËR BASHKËPUNIM DHE
ZHVILLIM (IBZH)
ZNJ. KRISELA HACKAJ**

**KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT (KSHH)
ZNJ. ERIDA SKËNDAJ**

**QENDRA EUROPIANE (QE)
ZNJ. INA XHEPA**

**INSTITUTI SHQIPTAR I SHKENCAVE (AIS)
ZNJ. ARANITA BRAHAJ**